



Planuar / Dorezuar Prijemno/Prudato Received/Delivered	08 - 04 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPS/SHCK	2005/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.246/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.246/2022 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë të datës 22.02.2022, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.246/2022 e datës 17.03.2022 e parashtruar nga ankuesi.

II. Mbetet në fuqi Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, i datës 22.02.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 17.03.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1421/2022 të regjistruar me numër A.nr.246/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 22.02.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Këshilli, me datë 04.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1421/2022 të regjistruar me numër A.nr.246/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emalin e datës 17.03.2022 nga ankuesi; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulet dhe Profesionale për vitin 2021 më datë 22.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 04.04.2022; Vendimin e datës 05.09.2018 për transferimin e ankuesit në pozitë Kordinator i Zyrës Rajonale në Mitrovicë; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Kordinator i Zyrës Regjionale i datës 17.03.2014; Emailin e datës 30.03.2022; Emailin e datës 31.01.2022 lidhur me vlerësimin; Emailin e datës 01.04.2022; Emailin e datës 01.04.2022 mbi raportin e zbatimit të masave COVID-19 dhe Raporti Javor; Emailin e datës 01.04.2022 nga ankuesi lidhur me raportin; Raportin e monitorimit të masave anti COVID-19; Shkresën për raportin nga Drejtorja e Inspektoratit për periudhën 28 mars deri 01 prill 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Vendimin me numër reference Ref.AUV.01-320/2018 të datës 05.09.2018 është konstatuar se ankuesi është në marrëdhënie të punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe i njëjti ushtron pozitën e punës *Koordinator i Zyrës Rajonale në Prishtinë*. Kolegji duke iu referuar shkresave të lëndës ka gjetur se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit, për vitin 2021 ka vlerësuar ankuesin me notë tre pikë zero (3.0), dhe rrjedhimisht pas kërkesës për rivlerësim ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme tre pikë dy (3.2).

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 është bërë në kundërshtim me rregulloren e punës dhe i njëjti kërkon që të bëhet rivlerësim sipas Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 43 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.* 2. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit”, dhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcakton, përkatësisht nenin 5 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar), dhe rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës ka gjetur se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në kuadër të objektivave të paracaktuar.**



Duke ju referuar formularit të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 është konstatuar se ankuesi është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me notën e përgjithshme tre pikë dy (3.2), që nënkupton se ka arritur të gjitha objektivat në kuptim të dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, përkatësisht nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: 1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë, ndërsa me paragrafin 2 nën paragrafit 2.3 të këtij neni, përcaktohet se: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në shkresa të lëndës nuk ka gjetur ndonjë dëshmi e cila mbështet pretendimin ankimor se ankuesi ka tejkaluar pritjet në realizim të objektivave, apo dëshmi tjetër se vlerësimi nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Rrjedhimisht Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenin 8, nenin 10, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kështu që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.246/2022

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Procesmbajtës



Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

